



Pranuar / Dorezuar Prijemeno / Predato Received / Delivered	19.12.2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypja Printog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SHANSHOC	7546/2023		112



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1529/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas ankesës me numër A.nr.1529/2023 të datës 15.12.2023, të parashtruar nga ankuesi në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 19.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1529/2023 të datës 15.12.2023 të parashtruar nga ankuesi

II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

A r s y e t i m

Ankuesi (me tej referuar vetëm ankuesi), me datë 15.12.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 7500/2023 të regjistruar nën shenjen A.nr.1529/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vërejtjes me shkrim të datës 13.11.2023 të Drejtorit të Qendrës së Kompetencës "11 Marsi" në Prizren.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar Kontratës së Punës me Nr.220/3 të lidhur ndërmjet ankuesit në njërin anë, dhe Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, në anën tjetër, ka gjetur se ankuesi mban pozitën e punës "Mësimdhënës" të cilën pozitë i njëjti e ushtron në Qendrën e Kompetencës "11 Marsi" në Prizren.

Kolegji i Këshillit, lidhur me statusin e ankuesit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 5 paragrafi 3 përcaktohet se: 3. *Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit,*

shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës, nga si rrjedhojë konstatoi se ankuesi për shkak të pozicionit të punës që mbanë aktualisht "Mësimdhënës" në Qendrën e Kompetencës "11 Marsi" në Prizren, Nuk e ka statusin e Nëpunësit të Shërbimit Civil, por i njëjti e gëzon statusin e Nëpunësit të Shërbimit Publikë, sikurse përcaktohet me nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Andaj, meqenëse nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur MbiKëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1529/2023 të datës 15.12.2023 të parashtruar nga ankuesi

Ndërsa, duke qenë se ankuesi nuk i ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës, Kolegji i Këshillit në zbatim të dispozitave të nenit 88 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi që kjo lenë t'i bartet për shqyrtim organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur MbiKëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1529/2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesi,
- Komisionit për Ankesa në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI);
- Udhëheqësit të Njësive të Burimeve Njerëzore në MASHTI; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

